

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / РЕСПУБЛИКА КОСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia.org. Org.leanica Org.Unit	5A-02
Nr. i Fajevë: Nr. Stranica No. Pages	-05-
Nr. i Prot. Prot. No.	3538-2/25
Emri: Datum:	18.08.25
PRISHTINË / A	
No. 1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	11.08.2025
REFERENC-Ë:	25/3538/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Drena" Sh.p.k. Skenderaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Izedin Bytyqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/3538/202/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për fabrikën për përpunimin e qumshtit, produkteve dhe nënprodukteve të tij.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "Drena" Sh.p.k. Skenderaj, pajiset me Pëlqim Mjedisor për fabrikën për përpunimin e qumshtit, produkteve dhe nënprodukteve të tij, nën kushtet si vijon:

- Ndërtimi i një sistemi për trajtimin e ujërave të ndotura para se të derdhen në rrjetin publik apo në mjedis.
- Monitorimi i përbërjes së ujërave që dalin nga procesi i përpunimit të qumështit (p.sh. yndyrna, proteina, detergjentë etj.).
- Pajisja me separatorë për yndyrna dhe materiale të ngurta.
- Leje ujore në rast se ka përdorim të ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore
- Klasifikimi i mbetjeve (organike, inorganike, të riciklueshme).



- Mbetjet organike (si hirra, mbetje qumështi, mbetje kafshësh) duhet të trajtohen në mënyrë të kontrolluar (kompostim, përdorim për ushqim për kafshë etj.) ose të dërgohen në impiante të licencuara.
- Ndërmarrja duhet të ketë kontrata me kompani të licencuara për trajtimin dhe transportin e mbetjeve.
- Pajisjet teknologjike duhet të përmbushin standardet për zhurmë dhe emetime.
- Nëse përdoren kazanë me djegie, duhet të kontrollohen emetimet e gazrave dhe të merren masa për uljen e ndotjes (filtra, ciklonë etj.).
- Ndërtesat dhe ambientet e jashtme duhet të jenë në harmoni me mjedisin përreth dhe të mirëmbahen për të mos ndikuar negativisht në pamjen vizuale.
- Magazinim në kushte të kontrolluara për të shmangur ndotjen e tokës, ujit ose ajrit.
- Depo të mbyllura për ruajtjen e qumështit, pluhurit të qumështit, përbërësve të tjerë.
- Platoja operationale duhet të jetë e izoluar dhe e betonuar me qëllim të mbojtjes nga rrjedhja e lëndëve djegëse ose vajrave .
- Ndalohet veprimtaria e Kompanisë "Drena" Sh.p.k. Skenderaj, për fabrikën për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.


Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

Pëlqimi Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumantacionit përcjellës të dorëzuar për kompaninë "Drena" Sh.p.k. Skenderaj, për fabrikën për përpunimin e qumështit, produkteve dhe nënprodukteve të tij, në ngastrat kadastrale nr. P-72015025-01111-0 Z.K. Klinë e Poshtme, Komuna e



Skenderaj, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerr Vendim për leshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 25 të Ligjit për VNM Nr. 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/3538/ - ZSP/ /25 datë: 11.08.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPHI-së
6. Komunës së Skenderajit

Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

